



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
KËSHILLI

Nr. 1041 / prot

Koplik më: 23/04 / 2026

**V E N D I M**

*Nr 19 datë 22 / 04 / 2026*

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e tij të datës 22.04.2026, mbeshtetur në aktin normativ nr 3 datë 15.03.2020 neni 5, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015. "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9 pika 1.7/a, të Ligjit 94/2022 "PËR TITUJT E NDERIT DHE TITUJT VENDORË TË NDERIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" neni 9 pika 1.

VKM Nr.861 datë 10.12.2014 Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhënien e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë.

**V E N D O S I**

T'i akordojë titullin "Qytetar Nderi "Z. Rrok Fran Gjelaj me motivacionin:

"Për punën dhe përkushtimin e tij si një qytetarë bashkohorë, si kontribues në artin e këngës popullore e qytetare e entokultures malësore sidomos në fushën e folklorit, ku si drejtues i Shoqatës Kulturore "Kënga Jonë" e me edicionin "Ku e muer emnin Malësia" ka qënë promotorr në vlerësimin e Malësisë me Titullin e Lartë "Nderi i Kombit", duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe e më gjerë. "

1. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Brendshme.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETAR**

Ilir Halaj

**SEKRETAR**

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 22.04.2026

Vota Pro 25

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 23.04.2026





**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BASHKIA MALESII E MADHE**

Nr. 1091/prot

Koplik më: 17/04/2026

**Këshillit të Bashkisë Malësi e Madhe**  
**Propozim për dhënie titulli “ Qytetarë Nderi “ i Bashkisë Malësi e Madhe**  
**z. Rrok Fran Gjelaj këngëautor**



Rrok Gjelaj ka lindur me 12 dhjetor 1954, në fshatin Rrjoll të Gruemirës e aktualisht banon në fshatin Hot i Ri të Shkodrës. Këngëtari i muzikës popullore ka një karrierë të gjatë mbi supe gjysmë shekullore. Ai mbahet mend si një nga këngëtarët që merr pjesë rregullisht në Festivalin folklorik të Gjirokastrës, që nga vitit 1965. Pjesëmarrës që nga Festivali i parë i Folkut në Gjirokastrë dhe në vazhdim. Ai është vlerësuar i vlerësuar 5 herë me çmimin “Laureat i Republikës” në këto festivale. Kantautor i shumë këngëve dhe melodive popullore Gjelaj është



vlerësuar dhe në disa çmime, ku mund të përmendim atë “Special” të fituar në Festival European të Foklorit në vitin 1996, të zhvilluar në Francë. Në vitin 1993 themelon shoqatën kulturore “Kënga Jonë”, të cilën dhe e drejton me sukses. Gjellaj njihet edhe si organizator i 5 edicioneve (e po përgatitet për të 6-tin): “Ku e muer emrin Malësia e Madhe”. Njëkohësisht është dhe instrumentist, pasi i bie bilbilit dhe çiftelisë. Këngëtari i njohur ka qenë edhe anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve. Ndërsa është vlerësuar dy herë nga dy presidentët Bamir Topi dhe Ilir Meta, “Naim Frashëri i Artë” dhe “Mjeshtër i Madh”. Ka një arriera 50-vjeçare në skenë. Pjesëmarrës në shumë aktivitete artistike në Gjermani, Zvicër, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Kosovë etj. Drejtues kulture para viteve 1990 për 20 vite në zona të ndryshme të Qarkut të Shkodër. Themelues e drejtues i shoqatës kulturore “Kënga Jonë” që nga vitit 1993 e në vazhdim. Kantautor i shumë këngëve dhe melodive popullore. I vlerësuar me titullin “Qytetar nderi” në katër njësi administrative të ndryshme të pushtetit vendor në Qarkun e Shkodrës e vlerësime në mbarë trojet shqiptare e Diasporë.

Për gjitha sa thamë më lartë i propozohet Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe ti jepet titulli “ Qytetarë Nderi “ i Bashkisë Malësi e Madhe me

**motivacion:**

*“Për punën dhe përkushtimin e tij si një qytetarë bashkëkohorë, si kontribues në artin e këngës popullore e qytetare e etnokultures malësore sidomos në fushën e folklorit, ku si drejtues i Shoqatës Kulturore “Kënga Jonë” e me Edicionin “Ku e muer emnin Malësia” ka qënë promotorr në vlerësimin e Malësisë me Titullin e Lartë “Nderi i Kombit”, duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe e më gjerë“.*

**KRYETAR BASHKIE**

**TONIN MARINAJ**

